



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 17 Mars 2021

Nr: 157

VENDIM

**PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALDEMOKRATE
PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72, pikat 1 e 2, dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, dhe të shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga Partia Socialdemokrate, për miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, dhe relacionin e paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92, shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Me vendimin nr. 77, datë 15.02.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Partia Socialdemokrate është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Në bazë të neneve 67 dhe 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Partia Socialdemokrate, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore më datë 8.3.2021.



Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 133, datë 10.03.2021, vendosi kthimin për korrigjimin e dokumentacionit, të listës shumemërore të kandidatëve për deputet të subjektit zgjedhor, Partia Socialdemokrate.

Brenda afatit ligjor subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate ridepozitoi dokumentacionin e korrigjuar. Dokumentacioni i paraqitur përmban:

1. Listat shumemërore për 12 Zonat Zgjedhore; Model - 03
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën e votës dhe se pranojnë të kandidojnë si kandidat të listës shumemërore të Partisë Socialdemokrate ; Model – 05;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumemërore;
4. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumemërore Model – 07;
5. Vërtetimin nga Kuvendi i Shqipërisë i cili vërteton se Partia Socialdemokrate ka deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
6. Formularët e vetëdeklarimit për të gjithë kandidatët, në zbatim të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
7. Deklaratën Model 03/1 për disa kandidatë të cilët kanë planifikuar marrjen/ pranim donacione.

Në mbështetje të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për deputet të Partisë Socialdemokrate dhe dokumentacionin përkatës ligjor të paraqitur dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara nga nenet 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor.

Në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit, nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, kandidatët për deputet, të subjektit politik Partia Socialdemokrate, kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, të kandidatëve për deputetë, rezultojnë se përveç kandidatëve të poshtëpërmendur, të gjithë kandidatët e tjerë nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.

1. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Kleo Hekuran Murataj**, kandidat për deputet, qarku Tiranë me numër rendor 4, rezultojnë se ka deklaruar :
Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,



Pikës 1, “*A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

- Është dënuar me vendimin nr. 129 datë 21.03.1991 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Është shoqëruar nga Policia e Hannover në vitin 2016, mbas shoqërimit është lënë i lirë.

Nga verifikimi prima facie i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet, nuk ka të dhëna të mjaftueshme për kategorizim të veprës penale. Për shkak se nuk disponojmë ende përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, konstatohet se kandidati për deputet nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhsmërisë në momentin e miratimit të listave shumëmemërore.

2. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Tom Gjek Doshi**, kandidat për deputet, qarku Shkodër me numër rendor 1, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pikës 1, “*A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

- Me vendimin nr. 8 datë 05.06.2015, Gjykata e Lartë, e ka dënuar për veprën penale “Shpifje”, parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal.
- Me vendimin nr. 18 datë 25.05.1990, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Rrethit Durrës, e ka dënuar për veprën penale “Sjellje e padenjë në shoqëri”, parashikuar nga neni 121 dhe 31/1 i Kodit Penal, për të cilën është dënuar më 1 (një) vit heqje lirie.

Pikës 4, “*A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Është ndaluar/arrestuar nga Prokuroria e Përgjithshme sipas urdhërit të datë 26.03.2015, sipas procedimit nr. 1 datë 20.03.2015, sipas neneve 305, 312/a dhe 305/a të Kodit penal, për të cilat është caktuar masa arrest në shtëpi, sipas vendimit nr. 15 datë 28.03.2015 , për periudhat 26.03.2015 deri më 28.03.2015.

Pikës 5, “*A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Është caktuar masë e sigurisë detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore dhe arrest me burg, masë e cila është revokuar.

- Gjykata e Lartë me vendimin nr. 15 datë 28.03.2015, ndryshuar masa në detyrim paraqitje me vendimin nr. 15/1 datë 28.04.2015, për veprën penale parashikuar nga nenet 305, 312/a dhe 305/a të Kodit Penal, për periudhën 28.03.2015-28.04.2015, për të cilën është vendosur masa e sigurisë arrest në shtëpi.



- Gjykata e Lartë me vendimin nr. 15 datë 28.04.2015, ndryshuar masa në detyrim paraqitje me vendimin nr. 15/1 datë 28.04.2015, shtuar masa me vendimin e pafajësisë nr. 2014 datë 04.07.2018, për periudhën 28.04.2015-04.07.2018, për të cilën është vendosur masa e sigurisë detyrim paraqitje.

Nga verifikimi prima facie i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, referuar deklarimeve të kandidatit për deputet, vërehet se vepra penale sipas vendimit nr. 8 datë 05.06.2015, të Gjykatës së Lartë, “Shpifje”, parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal si dhe vepra penale sipas vendimit nr. 18 datë 25.05.1990, të Kolegjit Ushtarak të Gjykatës së Rrethit Durrës, “Sjellje e padenjë në shoqëri”, parashikuar nga neni 121 dhe 31/1 i Kodit Penal, nuk përfshihen në sferën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Për shkak se nuk disponojmë ende përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, konstatohet se kandidati për deputet nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhshmërisë në momentin e miratimit të listave shumëmemërore.

3. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Ardian Luigj Nikulaj**, kandidat për deputet, qarku Lezhë me numër rendor 1, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pikës 1, “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

- Gjykata e Lezhë me vendimin nr. 124 datë 24.11.2003, e ka dënuar për veprën penale parashikuar nga neni 278, për të cilën është dënuar me 4 (katër) muaj.
- Gjykata e Lezhë me vendimin nr. 182 datë 01.12.2006, e ka dënuar për veprën penale parashikuar nga neni 174 dhe 186/1, për të cilën është dënuar me gjobë.

Pikës 5, “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Është caktuar masë e sigurisë arrest me burg, masë e cila është revokuar.

- Gjykata Lezhë në vitin 2003, e ka dënuar sipas parashikimeve të nenit 278 të Kodit Penal.

Nga verifikimi prima facie i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, referuar deklarimeve të kandidatit për deputet, vërehet se vepra penale sipas vendimit nr. 124 datë 24.11.2003, për të cilën është dënuar me 4 (katër) muaj, nuk përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Për shkak se nuk disponojmë ende përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve,



konstatohet se kandidati për deputet nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhshmërisë në momentin e miratimit të listave shumëmemërore.

4. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Gjergj Nikoll Piroli**, kandidat për deputet, qarku Lezhë me numër rendor 2, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pikës 1, “*A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Gjykata e Kurbinit në vitin 2000 e ka dënuar për veprën “Lidhje e paligjshme e energjisë elektrike”, parashikuar nga neni 137/1, për të cilën është caktuar masa e dënimit me 48 orë pune në interes publik. Nga verifikimi prima facie i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, referuar deklarimeve të kandidatit për deputet, vërehet se vepra penale “Lidhje e paligjshme e energjisë elektrike”, parashikuar nga neni 137/1, nuk përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Për shkak se nuk disponojmë ende përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, konstatohet se kandidati për deputet nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhshmërisë në momentin e miratimit të listave shumëmemërore.

5. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Sebastjan Marash Malotaj**, kandidat për deputet, qarku Lezhë me numër rendor 7, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pikës 1, “*A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Gjykata Lezhë me vendimin nr. 153 datë 05.03.2018, sipas parashikimeve të nenit 236/1 e ka dënuar me gjobë.

Pikës 5, “*A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Është caktuar masë e sigurisë arrest me burg, masë e cila është revokuar.

Nga Gjykata e Lezhës është caktuar masë e sigurisë detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore, masë e cila është revokuar.



Gjykata Lezhë, sipas urdhërit penal të miratuar, sipas parashikimeve të nenit 236/1 , është vendosur masa për periudhën dhjetor 2017 deri më mars 2018.

Nga verifikimi prima facie i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet, dënuar sipas parashikimeve të nenit 236/1 konstatohet se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar nëse kandidati është në kushtet e ndalimit. Në mungesë të përgjigjes nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, dhe për sa deklaron vetë kandidati, konstatohet se ai nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhshmërisë në momentin e miratimit të listave shumëmemërore.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit, nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, paragrafi 2, shkronja "b" dhe paragrafi 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me shkresën nr. 2191prot., datë 17.03.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatët për deputet në Kuvendin e Shqipërisë, të Partisë Socialdemokrate, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ende nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës tonë në lidhje me verifikimin e të dhënave të kandidatëve për deputet të Partisë Socialdemokrate.

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit për kandidatët për deputet, të Partisë Socialdemokrate nuk përfshihen në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr. 138.2015.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, 67, 72, pikat 1 e 2 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, në udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit", dhe në shkronjën "a", të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të ndryshuar,



VENDOS :

1. Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për deputetë, të Partisë Socialdemokrate për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për zonat zgjedhore, Qarku Berat, Qarku Dibër, Qarku Durrës, Qarku Elbasan, Qarku Fier, Qarku Gjirokastrë, Qarku Korçë, Qarku Kukës, Qarku Lezhë, Qarku Shkodër, Qarku Tiranë dhe Qarku Vlorë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





Lista shumemërore

Partia Socialdemokrate

Qarku Berat

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Rajmonda	Ramis	Dalipaj	26/10/1980	F
2	Ertigel	Gëzim	Bardho	22/07/1992	M
3	Muharrem	Nazmi	Senka	28/08/1986	M
4	Anisa	Shpetim	Hoxha	01/06/1994	F
5	Altin	Vait	Allidri	26/09/1988	M
6	Enea	Mustafa	Isufi	13/10/1991	M
7	Sejdi	Jetnor	Babaliu	06/06/1995	M
8	Anila	Kujtim	Bitri	22/08/1990	F
9	Kristel	Ilir	Frashëri	11/12/1996	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 9

Partia Socialdemokrate

Qarku Dibër

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Denis	Rifat	Skura	23/10/1992	M
2	Lora	Ruzhdi	Balliu	24/09/1999	F
3	Gazmir	Halil	Lala	28/05/1988	M
4	Bere	Avni	Veseli	01/08/1998	F
5	Xhesika	Albert	Muda	12/10/1997	F
6	Dorjan	Shaqir	Veseli	29/12/1998	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 6



Lista shumemërore

Partia Socialdemokrate

Qarku Durrës

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Gladiola	Bahri	Çopa	27/05/1995	F
2	Antonio	Leonard	Jorgji	13/02/1996	M
3	Lorenc	Pandeli	Shuka	12/07/1987	M
4	Krisabela	Albert	Muço	04/03/1990	F
5	Gazmir	Xheladin	Dauti	23/09/1986	M
6	Eldio	Tonin	Preçi	03/02/1999	M
7	Rrezarta	Xhevdet	Hoxha	26/08/1988	F
8	Florind	Hysen	Sala	10/11/1990	M
9	Astrit	Pjetër	Gjinaj	03/11/1975	M
10	Intjesa	Luan	Buci	02/12/1997	F
11	Artur	Mark	Dedja	07/08/1982	M
12	Ridjan	Dedë	Dedaj	03/01/1984	M
13	Enerida	Dëfrim	Xhepollari	20/01/1995	F
14	Artjola	Zymer	Dervishaj	13/08/1996	F
15	Mariklen	Enver	Haxhi-Jahja	25/08/1991	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 15

Partia Socialdemokrate

Qarku Elbasan

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Fatos	Alush	Idrizi	07/03/1972	M
2	Genta	Roland	Tela	24/04/1995	F
3	Hermes	Hysen	Dylgjeri	01/05/2002	M
4	Shpëtim	Bajram	Meta	27/02/1966	M
5	Klevis	Dalip	Bahja	10/12/1997	M
6	Rovena	Ramo	Bajrami	13/03/1992	F
7	Xhulian	Durim	Sulmina	29/07/1996	M
8	Kejsi	Sazan	Shingjergji	07/03/1999	F
9	Leme	Vathi	Hidri	29/10/1997	F
10	Franc	Lulezim	Hasa	31/12/1999	M
11	Xhoana	Astrit	Çala	02/08/1997	F
12	Ardit	Ymer	Kullafi	26/07/1988	M
13	Entela	Namir	Muça	05/09/1976	F
14	Ermal	Ferid	Muçaj	04/09/1995	M
15	Marjon	Haxhi	Kushi	12/06/1989	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 15



Lista shumemërore

Partia Socialdemokrate

Qarku Fier

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Oresja	Edmond	Baçe	27/02/1994	F
2	Markeljano	Miti	Puka	12/06/1995	M
3	Majlinda	Hekuran	Gropa	20/01/1966	F
4	Florjan	Sabaudin	Troka	05/02/1988	M
5	Krista	Aleksander	Topi	22/08/1995	F
6	Arjan	Belul	Ferko	02/01/1969	M
7	Griselda	Gramoz	Rushanaj	13/12/1976	F
8	Vojsava	Klement	Bushi	26/03/1995	F
9	Lefter	Mersin	Muskaj	12/10/1977	M
10	Fatbardha	Feçorr	Goga	04/06/1961	F
11	Alma	Luftetar	Guma	06/08/1985	F
12	Klevin	Shpëtim	Durraj	28/02/1995	M
13	Besjana	Ferdi	Lushaj	14/02/1990	F
14	Viktor	Rrapi	Goga	12/12/1959	M
15	Natasha	Thoma	Sollaku	05/04/1988	F
16	Jonil	Elmas	Gjata	01/02/1993	M
17	Klaudiola	Xhelil	Sinaj	08/01/1999	F
18	Geri	Bujar	Rama	02/08/2001	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 18

Partia Socialdemokrate

Qarku Gjirokastrë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Anduela	Mihallaq	Caca	23/07/1976	F
2	Hekuran	Veliko	Alia	23/10/1968	M
3	Nevila	Zini	Adhami	25/06/1978	F
4	Rigels	Petrit	Mëhilli	03/03/1985	M
5	Panajot	Kosta	Agora	03/08/1959	M
6	Ërmilda	Dashnor	Gjini	24/05/1986	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 6



Lista shumemërore

Partia Socialdemokrate

Qarku Korçë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Julian	Kujtim	Kodra	27/09/1976	M
2	Ina	Rolandi	Tabaku	29/08/1990	F
3	Kristi	Artan	Bejko	13/10/1996	M
4	Elena	Ilia	Skenderasi	09/06/1995	F
5	Orneli	Skender	Leka	04/06/1991	M
6	Dorjana	Milto	Petro	03/06/1995	F
7	Vladimir	Myslim	Malushi	03/07/1968	M
8	Anxhela	Vasil	Nune	08/01/1993	F
9	Bledar	Polikron	Xhaferi	20/09/1986	M
10	Viola	Lluka	Dalipi	01/08/1979	F
11	Ënerik	Luan	Baçi	30/08/1990	M
12	Migena	Muhamet	Pinderi	13/02/1987	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 12

Partia Socialdemokrate

Qarku Kukës

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Raimond	Qamil	Dogjani	19/07/1987	M
2	Rubin	Gëzim	Omuri	04/10/1998	M
3	Albiona	Misin	Thaçi	12/10/1987	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 3

Partia Socialdemokrate

Qarku Lezhë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Ardian	Luigj	Nikulaj	31/10/1972	M
2	Gjergj	Nikoll	Piroli	12/02/1967	M
3	Alketa	Nikoll	Pjetri	05/12/1990	F
4	Emanuel	Ndue	Gjoka	18/07/1991	M
5	Marko	Fran	Nik-ulaj	04/06/1997	M
6	Suada	Cun	Taflaj	16/11/1990	F
7	Sebastjano	Marash	Malotaj	26/02/1995	M
8	Xhulio	Selvator	Toma	07/09/1990	M
9	Malvina	Gjon	Bacaj	18/09/1989	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 9



Lista shumemërore

Partia Socialdemokrate

Qarku Shkodër

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Tom	Gjek	Doshi	06/06/1966	M
2	Gledis	Esat	Çeliku	06/08/1983	M
3	Meri	Gaspar	Markiçi	22/07/1983	F
4	Bilbil	Nuh	Dervishi	04/02/1962	M
5	Serdar	Qemal	Hoxha	05/10/1996	M
6	Amela	Zyhdi	Zaganjori	30/12/1987	F
7	Eduard	Frrok	Gjoka	14/07/1982	M
8	Fabio	Rudolf	Martini	25/11/1976	M
9	Marina	Angjelin	Duhani	28/08/1986	F
10	Samed	Ahmet	Bushati	27/04/1998	M
11	Ërsen	Esat	Bala	16/05/1985	M
12	Arjana	Muhamet	Ishmi	15/08/1985	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 12



Lista shumemërore

Partia Socialdemokrate

Qarku Tiranë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Tom	Gjek	Doshi	06/06/1966	M
2	Gertjan	Gëzim	Deda	14/01/1988	M
3	Flora	Ismail	Manuka	30/06/1982	F
4	Kleo	Hekuran	Murataj	22/06/1966	M
5	Albert	Qemal	Jaupi	13/03/1982	M
6	Valbona	Ditar	Zekaj	06/09/1980	F
7	Uarda	Kujtim	Celami	28/11/1989	F
8	Besart	Sulejman	Meta	23/08/1991	M
9	Irini	Kostandin	Goga	01/07/1978	F
10	Rigels	Gezim	Bejko	25/03/1976	M
11	Sinan	Mustafa	Shala	06/07/1957	M
12	Sejrije	Aqif	Nika	18/12/1992	F
13	Klodjan	Nazmi	Mema	21/05/1981	M
14	Zoj	Filip	Ndou	23/05/1992	F
15	Ndrec	Gjon	Llusku	23/02/1974	M
16	Dritan	Bektash	Arap	02/08/1976	M
17	Adiola	Ferit	Canameti	30/09/1995	F
18	Nikolin	Shan	Faslia	09/05/1969	M
19	Ëvisa	Besim	Valteri	28/02/1985	F
20	Benard	Tom	Martini	22/12/1982	M
21	Fatjon	Sulejman	Deda	30/03/1986	M
22	Lura	Hiqmet	Fida	26/04/1980	F
23	Denis	Rrustem	Preçi	07/07/1992	M
24	Danjel	Sherif	Garunja	15/05/1988	M
25	Orges	Asqeri	Shehaj	09/01/1982	M
26	Senëra	Skender	Hoxha	21/02/1990	F
27	Gazmend	Mehmet	Doda	25/04/1969	M
28	Teuta	Qaship	Dupi	30/03/1971	F
29	Radion	Elmas	Dhromi	10/04/1976	M
30	Elis	Flamur	Rakipaj	23/08/1990	M
31	Serxhia	Pashk	Çupi	27/11/1995	M
32	Mirlinda	Esat	Halili	02/03/1993	F
33	Fabjol	Lulëzim	Kurti	02/10/1987	M
34	Aida	Nevruz	Brahilika	17/04/1999	F
35	Bosian	Hajri	Lamaj	16/01/1997	M
36	Flavia	Fadil	Nuraj	27/09/1988	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor

36



Lista shumemërore

Partia Socialdemokrate

Qarku Vlorë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Namik	Sali	Jahaj	04/05/1954	M
2	Albana	Taip	Çuro	19/02/1972	F
3	Valdet	Rrapo	Xhaferaj	30/09/1991	M
4	Majkeljano	Albert	Zotaj	22/06/1990	M
5	Sidorela	Nimet	Skëndaj	12/08/1996	F
6	Kleitton	Fatos	Aliaj	19/02/1999	M
7	Gledjon	Esat	Ahmeti	26/06/1992	M
8	Rovena	Avni	Dauti	26/09/1993	F
9	Klaudjo	Kastriot	Myftari	17/07/1991	M
10	Gesian	Antest	Xhelaj	27/09/1997	M
11	Denisa	Arian	Maze	29/05/1991	F
12	Boran	Hekuran	Dogu	17/06/1999	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 12Subjekti Zgjedhor ka: 153 kandidatë